



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ prot

Gramsh, më/06/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 27.06.2018

Për: “Meteo”shpk

Adresa: Fshati Çekin, NJA Pishaj, pranë Uzinës, Gramsh.

Procedura e prokurimit: “Kërkese për propozime”, me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-71263-05-24-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës “Rikonstruksioni i rrugës Çekin – Tërvol” ,Njësia Administrative Pishaj” me afat 40 ditë nga dita e lidhjes së kontratës .

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 28/05/ 2018 [Nr. 21]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Shoqëria - “Meteo”sh.p.k**, me nr.Nipti L26310801C me vlerë të ofertës 2 475 000(dymilionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë)lekë,pa TVSH.
2. **Shoqëria- “Blerimi”sh.p.k** me nr.Nipti J62903384G me vlerë të ofertës 1 862 419 (njëmilionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë)leke,pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik - “Blerimi”sh.p.k,përkatësisht për arsyet:

Oferta e tij rezultoi anomalisht e ulët:

Në bazë të Udhëzimit nr.3 date 09.05.2017” Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik “,Me shkresë nr.3859 datë 08.06.2018 i janë kërkuar shpjegime me shkrim ofertuesit për të dhënë shpjegime lidhur me ofertën e tij ,anomalisht të ulët.shpjegime të cilat duhet te paraqiteshin me shkrim brenda 3 ditëve pune.Për shpejtësi veprimesh iu dërgua edhe në formë elektronike më datë 08.06.2018.

Ofertuesi ka dërguar shpjegime me nëpërmjet sistemit elektronik dhe jo në rrugë zyrtare sic e kërkon Udhezimi nr.3 datë 09.05.2017.

- Nga shpjegimet e dhëna ne SPE përveç argumentimit të vet në formën e një vetdeklarate, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse është kërkuar:
- Oekonomik ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet

teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e punimeve pranë autoritetit kontraktor. Nga vlerësimi i dokumentacionit të dërguar në SPE paraqitja e analizes teknike të pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve.

- Nga vlerësimi i dokumentacionit të dërguar në SPE , nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e punimeve në referim të gurmës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e punimeve por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurues të ofertuar.
- Sa më sipër duke qënë se shpjegimet nuk janë dërguar me shkrim pranë Autoritetit Kontraktor si dhe janë paraqitur në SPE sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentohet oferta anomalisht e ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, për këtë arsye oferta juaj refuzohet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë** Shoqërinë -“Meteo”sh.p.k ,Gramsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2 475 000(dymilionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë)lekë,pa TVSH,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh** kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj(nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [...], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.06.2018

Ankesa:**Nuk ka pasur ankesa .**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

LULJETA DOLLANI